



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/10

Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/10

Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen dhe alokohen mjete financiare në vlerë prej 6,800,000.00 € (gjashtë milion e tetëqind mijë euro), në Ministrinë e Shëndetësisë, në nën programin Shërbimet Përkatëse Farmaceutike, me kod 71300, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF)" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/10

Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 paragrafit 1. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Tremujor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 1 janar-31 mars 2021.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës në kuptim të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/10

Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Borxhit Shtetëror për vitet 2022-2024.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Thesarit të Kosovës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/10

Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2022-2024.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Kornizën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/10

Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Fushën e Pronësisë Industriale.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/10
Datë: 30.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet metoda e pagesës direkte (pagese e njëhershme) në formë të avancit tek UNOPS, në emër dhe për llogari të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe regjistrimi kontabël në SIMFK në kodin përkatës të avancit për pagesa direkte të huamarrjes, në vlerë prej 1,548,858.20 € (një milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë euro, e njëzet cent), në bazë të marrëveshjes të datës 1 prill 2021 në mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe UNOPS për prokurimin e aktiviteteve të përcaktuara me Ligjin Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës (BZHKE)- Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, si dhe bazuar në Marrëveshjen në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), datë 01.04.2021.
2. Avanci i regjistruar nga pika 1. e këtij vendimi, mbetet i hapur në një afat prej 8 muaj dhe do të mbyllet, përkatësisht arsyetohet nga Ministria e Shëndetësisë ashtu siç pranohen pajisjet e porositura dhe faturat sipas procedurave të blerjes së pajisjeve mjekësore, kryerjes së shërbimeve dhe ndërtimit të zinxhirit të ftohtë (qendrës për ruajtjen e vaksinave), subjekt i kësaj marrëveshje, por jo me vonë se 15.12.2021.
3. Pavarësisht nga pika 1. e këtij vendimi, transferimi i mjeteve në formë të avancit nga pika 1 e këtij vendimi, kushtëzohet dhe mund të ndodh pas pranimit paraprak të fondeve të kredisë nga BZHKE në llogarinë e përcaktuar në kuadër të Llogarisë së Vetme të Thesarit.
4. Autorizohet dhe obligohet Ministria e Shëndetësisë që të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e kushteve të marrëveshjes së ratifikuar me Ligjin Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës - Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, si dhe bazuar në Marrëveshjen në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS), datë 01.04.2021.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh që Marrëveshja në mes Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës (MSH) dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) e cila buron nga Ligji Nr. 07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës (BZHKE)- Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 parasheh ndërtimin e zinxhirit të ftohtë dhe prokurimin e pajisjeve mjekësore të ndërlidhura me vaksinim për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, marrë parasysh rregullat e disbursimit dhe prokurimit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës të cilat janë pjesë e marrëveshjes së ratifikuar që cekin aranzhimet e veçanta të projekteve me agjencitë e Kombeve të Bashkuara, mundësinë e pagesës në avans (pagesë e njëhershme; anglisht: single payment) si dhe në zbatim të nenin 14, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Sidoqoftë, pagesa e avancit sipas këtij vendimi, kushtëzohet me pranimin e fondeve të kredisë nga BZHKE. Pas pranimin të fondeve, ato regjistrohen në SIMFK me fondin burimor përkatës, dhe për pagesën e avancit përdoren këto kode.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë